



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 136 Dt. 30/12/2020



# ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

**RREGULLORE**

**PËR**

**FUSHËVEPRIMIN DHE KOMPETENCAT E  
KOMISIONIT PËR FARMACI SPITALORE**

Prishtinë, 2020

**KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësorë, nenit 20, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OFK-së, në mbledhjen e mbajtur me 26/12/2020, miraton këtë:



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 136 Dt 30/12/20

## **RREGULLORE**

### **PËR**

## **FUSHËVEPRIMIN DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT PËR FARMACI SPITALORE**

### **KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet fushëveprimtaria e Komisionit për Farmaci Spitalore (në vazhdim Komisioni), kompetencat ekskluzive dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e Komisionit.

#### **Neni 2 Përbërja e Komisionit**

1. Komisioni për Farmaci Spitalore është organ i Odës, në cilësi të komisionit të përkohshëm, i cili ushtron kompetencat që i janë njohur Odës në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Komisioni përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi i Odës në pajtim me dispozitat e aktit normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës.

### **KAPITULLI II – KOMPETENCAT E KOMISIONIT**

#### **Neni 3 Kompetencat dhe fushëveprimtaria e Komisionit**

1. Komisioni ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  1. Përkrahje profesionale e Farmacistëve Spitalor në Sektorin Publik dhe Privat në Republikën e Kosovës
  2. Krijimi i platformave për edukim dhe trajnim të farmacistëve spitalor
  3. Përkrahje institucionale të farmacistëve Spitalor për rekrutimin e tyre profesional në Institucionet Shëndetësore ( Klinikat, reparte, barnatore etj.)
  4. Konsultim i të deleguarit të OFK-së në komisionet për plotësim/ndryshim të legjislacionit që ndërlidhet me farmacinë spitalore ,

5. Konsultim i të deleguarit të OFK-së në komisionet për hartimin apo plotësim/ndryshimin e listës esenciale të barnave dhe paisjeve mjekësore dhe protokoleve mjekësore.
  6. Oragnizimi i takimeve të rregullta me farmacistët spitalor në nivel të vendit dhe diskutimi i përbashkët për sigurimin e avancimit të tyre personal dhe profesional në vendet adekuate të punës
  7. Rekomandim dhe sugjerime profesionale për të gjitha Institucionet Shëndetësore për sigurimin e produkteve dhe paisjeve medicinale spitalore në kushte emergjente dhe të jashtëzakonshme
  8. Promovimi i përdorimit të drejtë të produkteve dhe paisjeve medicinale spitalore.
  9. Kontakti i vazhdueshëm me Asociacionin e Farmacistëve Spitalor European.
  10. Organizimi i konferencave, trajnimeve, seminareve për farmacistët spitalor në nivel lokal dhe regjional.
2. Komisioni mund t'i ushtrojë edhe kompetencat e tjera që i barten nga organet e tjera të Odës me lejen e Këshillit Drejtues dhe që i përgjigjen natyrës së fushëveprimtarisë së Komisionit.

#### **Neni 5**

#### **Procedura e shqyrtimeve në Komision**

Procedurat përkitazi me mënyrën e funksionimit, vendimmarrjes, procedurave që ndiqen me rastin e shqyrtimit të çështjeve që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit, funksionimi i brendshëm dhe kompetencat e organeve drejtuese të Komisionit, zbatohen në përshtatje të dispozitave të Rregullores për procedurat vendimmarrëse të organeve të OFK-së.

#### **Neni 6**

Procedurat dhe rregullat mbi realizimin e këtyre kompetencave dhe çështjet tjera të cilat nuk janë të caktuar vendosen nga Komisioni me miratimin e Këshillit Drejtues të OFK-së

#### **Neni 7**

#### **Zbatimi i Rregullores**

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesen kryetari dhe anëtarët e Komisionit.

#### **Neni 8**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohen dispozitat ligjore të rregulloreve dhe vendimeve tjera të cilat janë në kundërshtim me këtë rregullore

#### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës.

Kryetari i OFK-së  
Dr. Arianit Jakupi

